



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 4.6 të Rregullës së KQZ nr. 01/2013 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 13. 01.2020, merr këtë:



V E N D I M

Për regjistrimin e Partisë Politike Socijaldemokratska Unija – SDU

- I. Regjistrohet Partia Politike 'Socijaldemokratska Unija' me akronim SDU, me kryetare znj. Duda Balje.
- II. Partia Politike Socijaldemokratska Unija - SDU, i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe obligimet e përcaktuara me nenet 3 dhe 4 të Rregullës zgjedhore 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- III. Partia Politike Socijaldemokratska Unija -SDU, obligohet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin në bazë nenit 15 të Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- IV. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta përgatit certifikatën e regjistrimit dhe ta regjistroj Partinë Politike Socijaldemokratska Unija - SDU në Regjistrin e Partive Politike të Kosovës.
- V. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta njoftoj partinë politike Socijaldemokratska Unija -SDU, për marrjen e këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjitha palët që kanë interes juridik kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.